**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

*Dokument parlamentar*

# PROCESVERBAL

Datë 05.10.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arta Dade – kryetare e Komisionit**

**(Procesverbal i mbajtur me shënime)**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

2. Seancë informuese me Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me OSBE-në dhe Këshillin e Europës.

3. Të tjera.

**Marrin pjesë:**

Arta Dade, Aldo Bumçi, Valentina Leskaj, Luljeta Arapi, Perparim Spahiu, Eduard Selami, Kastriot Islami, Shpëtim Idrizi.

**Mungojnë***:*

Namik Dokle, Edlira Çekrezi, Ben Blushi, Jozefina Topalli, Vangjel Dule.

**Të ftuar:**

Sokol Gjoka - Drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve Politike dhe të Sigurisë, Ministria e Punëve të Jashtme.

Venera Domi- Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare, Ministria e Punëve te Jashtme

## HAPET MBLEDHJA

**Arta Dade:** Kolegë duke ju uruar një javë të mbarë, nisim mbledhjen e Komisionit me këtë rend dite:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Sot kemi një Seancë informuese me Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me OSBE-në dhe Këshillin e Europës.

Si dhe çështje të tjera.

Për të shpjeguar rreth këtyre marrëdhënieve kemi të pranishëm Zotin Sokol Gjoka, Drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve Politike dhe të Sigurisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zonjën Venera Domi, Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare, Ministria e Punëve te Jashtme.

Ne kemi kërkuar nivelin e lartë të përfaqësimit, sigurisht nga ana profesionale kemi të bëjmë këtu me nivelin më të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, por sikurse ka dhe një nga Kryeministri në Komisionet e Kuvendit duhet të paraqitet në mungesë të Ministrit, Zëvendësministri ose Sekretari i Përgjithshëm. Shpresoj që Ministria e Punëve të Jashtme ta korrigjojë këtë në mbledhjen e nesërme e cila është lançuar, do të kemi një prezantim dhe diskutim lidhur me marrëdhëniet e Shqipërisë me Agjencitë e OKB-së, por edhe rolin që ne luajmë brenda kësaj organizate.

Kolegë keni ndonjë vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Jeni dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet.

Atëherë më lejoni t'i jap fjalën zotit Sokol Gjoka për të shpjeguar rreth marrëdhënieve që Republika e Shqipërisë ka me Organizatën për Bashkëpunim dhe Siguri në Europë dhe gjithashtu me Këshillin e Europës. Faleminderit Zoti Gjoka, keni fjalën.

**Sokol Gjoka**: Faleminderit zonja Kryetare! Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë. Është kënaqësi për në që të jemi përsëri në këtë sallë për të komunikuar me ju lidhur me politikat e Shqipërisë në raport me organizatat ndërkombëtare, konkretisht me organizatën e OSBE-së dhe Këshillit të Europës.

Zhvillimet reformuese në Shqipëri, rritja e rolit dhe profilit të saj, kryesisht në rajon dhe në arenën ndërkombëtare, ka ndikuar në një ndryshim të vazhdueshëm të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe OSBE-së, parë kjo edhe në këndvështrimin e politikave tre-përmasore të organizatës ndaj sigurisë në kontinentin Evropian.

Duke njohur dhe vlerësuar kontributin historik dhe aktual të OSBE-së në garantimin e sigurisë së kontinentit Evropian, Shqipëria është bërë pjesë e këtij kontributi. Ajo nuk është më konsumatore e ekspertizës së OSBE-së, por kontribuon në mënyrë të qenësishme në

ruajtjen dhe nxitjen e rolit të Organizatës në arkitekturën e sigurisë në Evropë me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë qoftë në vëzhgimin e zgjedhjeve, qoftë në forcimin e demokracive të brishta.

Shqipëria ka një bashkëpunim të mirë me institucionet e specializuara të OSBE-së, si Asamblenë Parlamentare të OSBE-së, ODIHR, HCNM (Komisionerja e Lartë e Pakicave Kombëtare) dhe RFoM (Përfaqësuesja e Lartë e Lirisë së Shtypit).

Vendi ynë përfaqësohet denjësisht në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së. Prania e vendit tonë, ndër të tjera, në misionet përkatëse vëzhguese zgjedhore, forcon bashkëpunimin ndërkombëtar në mbështetje të angazhimeve politike, të sigurisë, çështjeve ekonomike, mjedisore dhe të drejtave të njeriut.

Parlamentarët tanë kanë marrë pjesë në proceset e monitorimit të zgjedhjeve parlamentare në disa vende të kontinentit tonë si dhe kanë dhënë kontributin e tyre në diskutimet dhe trajtesat që ka bërë ky institucion i rëndësishëm i kësaj organizate, duke përcjellë mesazhe të rëndësishme të politikës sonë të jashtme.

Bashkëpunimi me ODIHR është përqendruar në përgatitjen dhe forcimin e kapaciteteve tona të vëzhgimit të zgjedhjeve.

Me dëshirën e mirë të Qeverisë Shqiptare për të përmirësuar edhe më shumë mjedisin zgjedhor dhe standardet e zgjedhjeve, bashkëpunimi me ODIHR do të jetë edhe më konkret gjatë vizitës që Ambasadorja Audrey Glover, Kreu i Misionit Vëzhgues Zgjedhor do të organizojë së shpejti në Tiranë për të dorëzuar Raportin Përfundimtar të Zgjedhjeve Vendore që u zhvilluan në vendin tonë më 21 qershor 2015.

Me të njëjtin intensitet dhe efektivitet ka qenë edhe bashkëpunimi me RFoM (Përfaqësuesen e OSBE-së për Lirinë e Shtypit) që është përqendruar kryesisht në nxitjen e pluralizmit në media, përfshirë rrjetet sociale, dixhitale dhe internetin, çka është në përputhje të plotë me mandatin e kësaj përfaqësuese të miratuar në vitin 1997.

Janë bërë përpjekje maksimale që HCNM (Zyra e Komisioneres së Lartë të OSBE-së për Pakicat) të jetë një instrument i duhur dhe efikas për të trajtuar shqetësimet e bashkëkombësve tanë në rajon, përkatësisht vendit ku ata ndodhen. Kështu, asaj i është sugjeruar të kërkojë vazhdimisht nga Qeveria Serbe të plotësojë kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, ndërsa në Maqedoni të këmbëngulte që Marrëveshja e Ohrit të zbatohet plotësisht, në gërmë dhe në frymë etj.

Si organizatë e sigurisë, OSBE-ja e shqyrton atë në mënyrë të plotë dhe punon ta trajtojë në të tria përmasat e veta: politike-ushtarake, ekonomiko- mjedisore, si dhe ato të njeriut - si një tërësi të integruar.

Angazhimet e çdo Shteti pjesëmarrës të OSBE-së në përmasën e parë (të sigurisë) janë politikisht dhe ligjërisht të detyruar të zbatojnë politika të gjithë pranuara, gjë që, nga ana e vendit tonë janë përmbushur në kohë e me cilësi, nëpërmjet raporteve të dorëzuara sipas dokumenteve dhe konventave në fushat përkatëse.

Në përputhje me vizionin e përgjithshëm dhe strategjinë e institucioneve dhe praktikave të Shqipërisë, me një theks të veçantë në funksionimin e institucioneve dhe marrëdhënieve me qytetarët, bashkëpunimi ynë me OSBE-në në përmasën e II-të (ekonomike-mjedisore) synon të rrisë kapacitetet institucionale në mënyrë që të jenë më efektive dhe transparente.

Sa i përket përmasës së dytë, dhe për shpeshtësinë e raportimeve vullnetare një shembull pozitiv në këtë drejtim ka dhënë Ministria e Pushtetit Vendor, e cila ka qenë mjaft aktive në trajtimin nga Qeveria shqiptare të çështjes së luftës kundër korrupsionit. Ky rast ka nxitur vende të rëndësishme partnere, anëtare të OSBE- se, të sugjerojnë që, në vitet në vijim, në këtë Komitet të përdorej praktika e raportimeve vullnetare dhe e ndarjes së praktikave më të mira midis vendeve anëtare.

Nëse përmasa e tretë, ajo njerëzore, cilësohet si më e rëndësishmja, vendi ynë ka qenë më shumë se aktiv në punimet e komitetit përkatës. Është bërë tashmë traditë që vendi ynë të paraqesë vullnetarisht raporte në punimet e komitetit të përmasave njerëzore. Rasti i fundit është ai ku Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka paraqitur dy raporte gjatë këtij viti, duke ndarë përvojën tonë me të tjerët, gjë që është vlerësuar shumë nga organizata dhe nga partnerët. Bashkëpunimi i vendit tonë me organizatën, në këtë përmasë, shkon në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it për kodin zgjedhor, të drejtat e romëve, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e grave, trajtimi i dhunës në familje, etj. Janë bërë vlerësime konstruktive për çështje si toleranca dhe mos-diskriminimi, antisemitizmi, etj.

Mandati i Pranisë së OSBE-së në Tiranë është në përputhje me dokumentin e miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm i OSBE-së në vitin 2003. Mandati i Përfaqësisë së kësaj organizate është i përqendruar në:

- Reforma legjislative dhe gjyqësore, përfshirë reformën në pronësi;
- Reforma administrative rajonale;
- Reforma zgjedhore;
- Forcimi i kapaciteteve të Kuvendit;
- Lufta kundër trafikut dhe korrupsionit, përfshirë mbështetjen e zbatimit të strategjive kombëtare përkatëse;
- Zhvillimi i ligjeve dhe rregulloreve efikase për një media të pavarur si dhe një Kod Etike;

• Nxitja e mirë administrimit dhe projekteve për forcimin e shoqërisë civile;

• Mbështetje për policinë, veçanërisht, në trajnimin e policisë kufitare etj.

Gjatë harkut kohor 2003-2015 Shqipëria ka përjetuar zhvillime të jashtëzakonshme - në planin e brendshëm dhe të jashtëm dhe që lidhen me vetë rolin e vendit në Organizatë.

Zhvillimet pozitive të demokracisë shqiptare, rritja e rolit dhe profilit të Shqipërisë në rajon, në arenën ndërkombëtare dhe në vetë Organizatën e OSBE-së, anëtarësimi në NATO dhe marrja e statusit të vendit kandidat në BE, kanë sjellë një ndryshim rrënjësor të marrëdhënieve me OSBE-në. Shqipëria nuk është vetëm konsumatore e ekspertizës së OSBE-së, por kontribuon në mënyrë të qenësishme në ruajtjen dhe promovimin e rolit të Organizatës në arkitekturën sigurisë Evropiane.

Bashkëpunimi i Shqipërisë me Këshillin e Europës

Bashkëpunimi me KiE-n synon përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga anëtarësimi, me qëllim forcimin e demokracisë, shtetit ligjor dhe të drejtat e njeriut, bashkëpunim që vlerësohet si i frytshëm. Veprimtaria e KiE-s në vendin tonë përqendrohet në dhënien e ndihmës për institucionet shqiptare për arritjen e standardeve në fushat përkatëse.

Forcimi i bashkëpunimit të Shqipërisë me Këshillin e Europës zhvillohet nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të vendit tonë në forumet përkatëse të saj, si në Komitetin e Ministrave, në Asamblenë e Përgjithshme të Këshillit të Europës, në komitetet e ekspertëve etj.

Pjesëmarrja në punimet e Asamblesë Parlamentare të KiE-së (aktualisht, sesioni i vjeshtës 28 shtator - 2 tetor 2015) me një delegacion të deputetëve, përmbush edhe përmasën ndërparlamentare të këtij bashkëpunimi. Ministria e Punëve të Jashtme e vlerëson të rëndësishëm rolin aktiv të Delegacionit tonë Parlamentar në Asamblenë Parlamentare të KiE-s dhe ndërveprimin për të kërkuar kalimin në fazën post-monitoruese, duke përcaktuar qartë kushtet për këtë çështje.

Shqipëria dhe KiE kanë një bashkëpunim me plane të mirë-përcaktuara në shtrirje kohore dhe në bashkërendim të veprimeve të përbashkëta.

Komiteti i Ministrave, pasi ka vlerësuar në korrik 2014 përparimin e arritur të Shqipërisë në fusha të tilla si lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, liria e shprehjes, qeverisja demokratike dhe demokracia lokale, ka përgatitur Dokumentin e ri të Bashkëpunimit për periudhën 2015-2017 që është miratuar në muajin prill 2015 nga Komiteti i Ministrave të KiE-s. Dokumenti i tanishëm është një instrument programues strategjik dhe sektorial. Fushat kryesore përparësore të këtij Dokumenti të identifikuara në bashkëpunim me autoritetet shqiptare janë: realizimi i reformës në drejtësi; qeverisja e mirë dhe pjesëmarrja demokratike; të drejtat e njeriut; sistemi i burgjeve; lufta kundër korrupsionit dhe krimit të

organizuar; forcimi i demokracisë lokale; barazia gjinore; përfshirja sociale; komunitetet vulnerabile.

Rezoluta mbi Raportin e Komitetit të Monitorimit mbi "progresin e procedurave të monitorimit të Asamblesë Parlamentare", e paraqitur gjatë sesionit të vjeshtës të APKiE (tetor 2014-gusht 2015) përshëndet zbatimin e suksesshëm të fazës së parë të Reformës territoriale-administrative, mbajtjen e zgjedhjeve vendore si dhe marrëveshjen e dhjetorit 2014 mbi kthimin e opozitës në parlament, si dhe jep disa rekomandime.

Bashkëpunimi konkret dhe i afërt me Komisionin e Venecias do të finalizohet në sesionin e radhës të 23-24 tetor 2015.

Ndër arritjet dhe frytet e bashkëpunimit të vendit tonë me KiE-n veçojmë vendimin së fundmi të Komitetit të Ekspertëve mbi Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave (MONEYVAL) për daljen nga procedura e "regular follow-up", mbështetur në masat e marra dhe përparimin e arritur nga vendi ynë për zbatimin e rekomandimeve të këtij Komiteti.

Marrëdhëniet tona me Kongresin e Autoriteteve Vendore në punimet e sesionit të radhës 20-22 tetor 2015 do të kenë të veçantë diskutimin, ndër të tjera, të Raportit të Monitorimit të Zgjedhjeve vendore në Shqipëri.

Kosova më pranë KiE

Shtimi dhe intensifikimi i kontakteve të KiE-s me institucionet e Kosovës, në funksion të afrimit të mëtejshëm të saj me KiE-në, me synim anëtarësimin e Kosovës në Organizatë, ka qenë një tjetër objektiv i bashkëpunimit të vendit tonë me organizatën. Në këtë kuadër është punuar dhe janë realizuar:

- Anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në Bankën për Zhvillim të KiE;
- Anëtarësimi i Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit. MPJ ka lobuar intensivisht me vendet kryesore për realizimin e këtij objektivi;
- Miratimi i Dokumentit të Bashkëpunimit KiE-Kosovë (mars 2015), që përcakton aktivitetet dhe fushat kryesore të bashkëpunimit, duke bërë të mundur që edhe Kosova të përfitojë nga zbatimi i standardeve të KiE.

Këto do të ishin disa parashtresa të cilat ne menduam t'ju sjellim në vëmendjen tuaj përpos materialit që kemi shpërndarë i cili është më i gjerë, në mënyrë që të japim linjat kryesore të punës së Qeverisë Shqiptare në raport me dy Organizata të rëndësishme të kontinentit tonë siç është OSBE-ja dhe Këshilli i Europës. Ju faleminderit për vëmendjen.

**Arta Dade**: faleminderit Zoti Gjoka. Po zoti Bumçi.

**Aldo Bumçi**: Zonja Kryetare për procedurë unë kërkoj që të ftohen mediat në Komision. Ky është një zhvillim i paprecedentë, që të dalë media kur mbledhja është e hapur nuk ka

asnjë material konfidencial. Ky është një material që u lexua nga drejtori, material publik, është thjesht një përmbledhje e materialeve publike në lidhje me marrëdhëniet me një institucion, nuk ka asgjë konfidenciale.

**Arta Dade**:.... po kolegë pyetje.

**Valentina Leskaj**: kisha dy pyetje në lidhje me Këshillin e Europës dhe me funksionimin ndërinstitucional do të thoja që adreson shqetësimin për rakordim për raportimin, unifikimin e qëndrimit dhe mesazheve për sa i përket politikës së jashtme. Dëgjova këtu se është paraqitur dokumenti strategjik i bashkëpunimit në Komitetin e Ministrave në Këshillin e Europës. A ka pasur përpjekje për të bashkëpunuar, për të rakorduar me delegacionin e Parlamentit Shqiptar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës? Të paktën një informacion për delegacionin tonë.

E dyta a e shihni ju të arsyeshme që debatet që bëhen në Komitetin e Ministrave të jetë i azhurnuar edhe delegacioni i Parlamentarëve në Këshillin e Europës, në mënyrë që qëndrimet tona të jenë të rakorduara, pavarësisht se ne asnjëherë nuk ndodh që përpara se të nisemi për në Strasburg, të mos i kërkojmë qëndrimin e Ministrisë së Jashtme. Pavarësisht asaj çka na vjen, si cilësi, më vjen keq ta them këtë sepse në kërkesën e fundit që kam bërë, ka ardhur një letër nga zëvendësministrja, më vinte raporti i vitit të kaluar dhe rezoluta. Më fal po me raportin dhe rezolutën ne kemi punuar vetë, e kemi negociuar vetë, e kemi amenduar vetë, e kemi mbrojtur vetë, kemi qenë aktorë nga fillimi deri në fund. Kërkojmë qëndrimet politike për çështje delikate që diskutohen në Këshillin e Europës, sidomos ishte dhe çështje e Kosovës. Ky ishte shqetësimi jonë sepse raportet ne i kemi këtu.

Unë besoj që kemi nevojë edhe për pjesë të tjera, sepse pavarësisht se jemi delegacion i Asamblesë Parlamentare, në fund të fundit në Parlament raportohet që nga Komisioni Venecias deri tek OECD. Është vendi ku diskutojnë të gjitha institucionet e Këshillit të Europës, ndaj unë mendoj që nga kjo pikëpamje Parlamenti duhet të jetë më i azhurnuar, një mënyrë bashkëpunimi dhe raportimi permanent.

**Arta Dade**: kam një pyetje lidhur me monitorimin që Këshilli i Europës vazhdon t'i bëjë Shqipërisë. Cilat janë arsyet që ky monitorim vazhdon kur dihet që përgjithësisht monitorimi është për vendet që kanë probleme me demokracinë dhe për një vend që ka marrë statusin e vendit kandidat? Nuk e di nëse nuk jam e mirë informuar, por që nuk është normale që të vazhdojë të monitorohet nga Këshilli i Europës. Ka një kontradikte në këtë çështje dhe a ka përpjekje nga ana e Qeverisë Shqiptare për të bashkëpunuar me institucionet përkatëse të këshillit të Europës lidhur me heqjen e monitorimit?

**Sokol Gjoka**: lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër jo vetëm të Këshillit të Europës por në përgjithësi në kuadër të organizatave ndërkombëtare, është e vërtetë që Ministria e Jashtme ka një rol jo vetëm koordinues me institucionet e tjera, qofshin ato të ekzekutivit apo të legjislativit për sa i përket adresimit të çështjeve të organizatave ndërkombëtare por ka edhe një rol udhëheqës në proceset sepse është në kontakt të drejtpërdrejtë me organizatat ndërkombëtare dhe merr dhe përcjell mesazhet, organizon dhe ngre politike, orienton qëndrimet në raport me organizatat ndërkombëtare. Është në praktikë të punës të institucionit të punëve të jashtme që të jetë i mirë koordinuar me të gjitha institucionet e ekzekutivit dhe legjislativit në mënyrë që edhe politikat edhe qëndrimet në raport me organizatat ndërkombëtare të jenë sa më efektive. Kjo s'do të thotë se nuk ka vend për përmirësim. Vend për përmirësim ka gjithmonë dhe rasti që ju përmendët lidhur me udhëzimet që ju prisnit sugjerimet dhe udhëzimet nga Ministria e Jashtme lidhur me aktivitetin në Asamblenë Parlamentare tregon një lloj problematike, megjithatë kemi parasysh që veçanërisht në përgatitjen e dokumenteve kryesorë të shtetit shqiptar në raport me organizatat ndërkombëtare, veçanërisht me veprimtaritë e rëndësishme të këtyre organizatave, siç janë Komiteti i Ministrave, Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme Parlamentare apo qoftë edhe mbledhje Komisionesh të cilat trajtojnë problematika të karaktereve të ndryshme, ne natyrisht kemi një shkëmbim informacioni dhe një bashkëpunim me institucionet e linjës në mënyrë adekuatë.

Në raport me bashkëpunimin me Parlamentin kemi patur një lloj bashkëpunimi por unë kam përshtypjen që ky bashkëpunim duhet të arrijë nivele më të larta cilësore sepse ka fusha ku ne jo vetëm duhet ta mbajmë të mirë informuar këtë institucion, veçanërisht Komisionin për Politikën e Jashtme, por nga ana tjetër për të qenë edhe të mirë koordinuar edhe në qëndrime edhe në politika. Kështu që këtë e marrim edhe si një vërejtje për punën tonë të ardhshme por edhe si një angazhim tonë për të përmirësuar punën në këtë drejtim.

**Venera Domi**: mund të bëj dhe një sqarim në lidhje me dokumentin e Bashkëpunimit.

Dokumenti i Bashkëpunimit të Këshillit të Europës me Shqipërinë është një përmbledhje projektesh për një periudhë katër vjeçare në mbyllje të dokumentit të mëparshëm i cili përfundoi në vitin 2014 dhe që u konsideruar një sukses pasi arriti që brenda periudhës katër vjeçare të shpenzonte të gjitha paratë e vëna në dispozicion të qeverisë shqiptare për projekte të cilat janë për forcimin e kapaciteteve të brendshme. Për hartimin e dokumentit të ri është bërë një fushatë e gjerë konsultimi me të gjitha institucionet, për këtë është njoftuar edhe Kuvendi. Është fjala për projekte konkrete nuk është fjala për një dokument të politikave strategjike. Pra janë projekte konkrete të fushave të ndryshme. Ka qenë një periudhë e gjatë

konsultimi, rreth 8 muaj, dhe janë përcaktuar prioritetet në të cilat do të fokusohet asistenca financiare, ekspertiza e Këshillit të Europës me Shqipërinë për katër vitet e ardhshme. Në lidhje me

Për sa i përket punës së heqjes së monitorimit nga Organizatat ndërkombëtare procesin e monitorimit. Këshilli Europës ka dy lloj monitorimesh: një që është i Këshillit të Ministrave dhe tjetri i Asamblesë Parlamentare. Shqipëria ka dalë nga monitorimi i Komitetit të Ministrave dhe është ende nën monitorim nga Asambleja Parlamentare. Në lidhje me këtë ka disa kritere të cilat vendi ynë duhet t'i përmbushë, disa janë të karakterit politik si përmbushja e shtetit të së drejtës, e nivelit të demokracisë, dhe një tjetër është. Një tjetër moment kyç që ka mbetur nga angazhimet që ka marrë shteti shqiptar në momentin e anëtarësimit në Këshillin e Europës, në vitin 95 ku ishte një listë dokumentesh në të cilat vendi ynë duhej të aderonte. Të gjitha këto janë përmbushur me përjashtim të një dokumenti, të Kartës Europiane të Gjuhëve minoritare dhe rajonale.

Ministria e Jashtme ka ndërmarrë një proces konsultimi me Ministritë e linjës për të parë se cilat janë mundësitë e vendit tonë për të aderuar në të ose jo në varësi të angazhimeve që kërkon qeveria shqiptare si në aspektin e politikave të ndryshme që duhet të ndjekë ashtu dhe në atë financiar, pasi çdo anëtarësim ka edhe një faturë financiare. Në përfundim të këtij procesi, në bashkëpunim dhe me Këshillin e Europës, dhe do të përfshijmë edhe delegacionin e Kuvendit në Asamblenë Parlamentare në Këshillin e Europës, do të shohim cilat janë mundësitë.

**Arta Dade:** ndoshta është një specifikë e Këshillit të Europës. Në organizmat e tjera nuk mund të ndodhi kjo, ka një unifikim përgjithësisht të qëndrimeve.

**Valentina Leskaj**: ka një specifikë Këshilli i Europës. Me të drejtë Shqipëria është një vend që ka statusin e vendit kandidat e ndërkohë vazhdon monitorimin. Monitorimi në Këshillin e Europës është ndryshe nga vendet e tjera, për shembull janë dy shtete anëtare të Bashkimit Europian që diskutohet të futen në monitorim. Debatin e fundit e kemi patur diskutimin për Francën dhe Hungarinë për tu futur në monitorim. Hungaria për shkeljen e të drejtave të njeriut sidomos për lirinë e medias. Ndërkohë me strategjinë e re që ka adaptuar Këshilli i Europës dhe Komiteti i Monitorimit është që do anohet më shumë në monitorim jo sipas vendeve por sipas çështjeve. Monitorim tematike për shtete që pavarësisht që janë edhe anëtare të Bashkimit Europian.

Një sqarim për çështjen e monitorimit, thuhej se është diskutuar raporti për Shqipërinë, në këtë sesion të AP Këshillit të Europës dhe Shqipëria është mbajtur në monitorim. Nuk ka patur asnjë diskutim për Shqipërinë në Këshillin e Europës, nuk është diskutuar fare në do

jetë në monitorim apo në post monitorim. Është përgatitur një informacion nga reporterët i cili do të paraqitet në Komitetin e çështjeve politike në nëntor, por është vetëm një informacion mbas vizitës së reporterëve. Unë e kam lexuar sepse ma kanë dërguar reporterët, konkluzionet janë pozitive. Nuk është bërë diskutim, nuk është diskutuar çështja e statusit të monitorimit apo post monitorimit, do të ketë vetëm një informacion nga reporterët më 15 nëntor në Komitetin e Monitorimit në Paris.

**Arta Dade**: kur mendoni se do të hiqet monitorimi nga Asambleja Parlamentare?

**Sokol Gjoka**: duke patur parasysh specifikën e Këshillit të Europës dhe duke ditur këto politika të qarta që janë përcaktuar tashmë në raport me Shqipërinë në Komitetin e Ministrave besoj që do të ketë dhe një strategji për dalje nga monitorimi nga Asambleja e Përgjithshme Parlamentare e Këshillit të Europës. Ne jemi duke e ndjekur hap pas hapi procesin në bashkëpunim me delegacionin tonë dhe me kontributet e institucioneve përkatëse në mënyrë që ky proces i daljes nga monitorimi të ndodhi sa më shpejt për vetë faktin që tashmë Shqipëria është në një tjetër stad zhvillimi, është në një stad tjetër marrëdhëniesh kontraktuale me organizma të rëndësishme të Europës si është Bashkimi Europian, është vend anëtar i NATO-s me standarde të tjera. Kështu që me këto kushte duke pasur parasysh pesë kushtet që ne po përmbushim aktualisht në kuadër të hapjes së negociatave me Bashkimin Europian, pikërisht një pjesë e tyre trajtohen edhe nga kjo organizatë. Duke pasur një balancë të përqasjes sonë ndaj këtyre çështjeve mendoj që edhe politika e Asamblesë Parlamentare do të shkojë drejt daljes nga procesi monitorimit. Ndërkohë dokumenti që thamë është një lloj procedure që duhet ndjekur me përparësi.

**Valentina Leskaj**: procesi i bashkëpunimit të Shqipërisë me Këshillin e Europës është shumë i mirë dhe ka një rol tepër aktiv.

Edhe në qoftë se i referohemi raportit të fundit të Këshillit të Europës, Raporti i Progresit të Komitetit të Monitorimit, natyrisht shënon disa arritje, si ajo mbi reformën e territorit, çështja e të drejtave të njeriut dhe një sërë hapash të bërë nga Shqipëria të cilat janë vlerësuar pozitivisht.

Këshilli i Europës është shumë i rakorduar me Bashkimin Europian, shkëmbejnë rregullisht të gjitha informacionet. Ato që mbeten çështje sensitive është çështja e reformës në drejtësi, çështja e dekriminalizimit, klima politike. Ndërkohe theksoj edhe një herë që në vlerësimin e fundit që dy reporterët kanë bërë mbi Shqipërinë, vlerësojnë hapat serioz që janë bërë qoftë për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ashtu dhe vullnetin politik për të bërë reformën në drejtësi dhe dekriminalizimin. Ndërkohë që ka një vlerësim pozitiv edhe për sa i përket reformës territoriale sepse është e lidhur me autonominë

vendore dhe me standardet e demokracisë. Shqipëria është me një reporter, po zgjidhet një i ri, mbi bazën e tyre do të bëhet shqyrtimi në Komitetin e monitorimit, por nuk besoj se ka një kohë të përcaktuar se kur do diskutohet raporti për Shqipërinë. Në momentin që do ketë një raport për Shqipërinë do diskutohet, për momentin ende nuk ka një raport për Shqipërinë.

**Arta Dade**: kolegë kush e do fjalën?

Falenderoj zotin Gjoka dhe Zonjën Domi, duke mbështetur marrëdhëniet pozitive që Republika e Shqipërisë ka me këto organizma të rëndësishëm të cilët ndër vite kanë kontribuar në konsolidimin e demokracisë, në konsolidimin e të gjitha institucioneve që e bëjnë Shqipërinë një vend me dinjitet dhe që kanë shtruar rrugën për mbushjen e standardeve që Shqipëria të jetë një anëtare me të drejta të plota. Unë besoj që prezenca jonë diplomatike si në OSBE, ashtu edhe në Këshillin e Europës duhet të ketë një marrëdhënie pozitive edhe me Parlamentin. Dua të bëj një veçim këtu, unë si kryetare e delegacionit në Asamblenë Parlamentare të OSBE-në dua të vlerësoj bashkëpunimin e ngushtë dhe të gjitha shkresat që janë vënë në dispozicion të Komisionit për Politikë të Jashtme por edhe delegacionit në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së dhe padyshim që do vazhdojmë të luajmë rolin tonë si partnerë serioz në Këshillin e Europës dhe në OSBE duke kërkuar nga Ministria e Jashtme që të shikohet mundësia edhe e kandidimit në poste të rëndësishme të ekzekutivit në këto organizma, duke qenë se ka mjaft kapacitete. Ka ardhur koha që ne te kemi prani më të madhe në të dy organizmat.

Dua të vlerësoj rolin që kemi luajtur brenda OSBE-së në lidhje me çështjet e sigurisë, me praninë e monitorëve ne Ukrainë por edhe më gjerë. Ashtu sikurse u tha këtu Shqipëria nuk është më një konsumatore e praktikave dhe çështjeve të sigurisë por padyshim është edhe një kontributor në politikat e saj rajonale por edhe si pjesë e koalicioneve të fuqishme për çështjet e sigurisë që shtrihen përtej rajonit tonë madje përtej Europës.

Ju falenderoj për shpjegimet shteruese që dhatë.

**MBYLLET MBLEDHJA**